



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.713/05

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, ne kontestin e paditësit E. Sh. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av. I. K. nga Prizreni, kundër te paditurit F. K. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të borxhit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 19.11.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit E. Sh. nga Prizreni, përmes së cilës ka kërkuar qe "të obligohet i padituri F. K. nga Prizreni, që paditësit t'ia paguaj vlerën prej 120.000 euro në emër të borxhit për kthimin e investimeve të investuara nga paditësi E. Sh. në ndërtimin e pishinës "M.", me lokacion në Prizren, të gjitha këto me kamatë ligjore nga data e parashtrimit te padisë, si dhe që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 1065 euro", **si tërësisht e PABAZUAR.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të palës se paditur, konform nenit 423 par. 4, lidhur me nenin 438 par. 4 te Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Paditësi përmes të autorizuarit të tij av. I. K. nga Prizreni, me datë 31.08.2005, pranë Gjykatës Komunale në Prizren ka parashtruar padi për kompensimin e borxhit kundër te paditurit F. K. nga Prizreni, në te cilën ka theksuar se me të paditurin në vitin 2000, kanë arritur marrëveshje gojore dhe të shkruar për investimin e përbashkët për ngritjen dhe rregullimin e pishinës "M.", e cila gjendet afër ish fabrikës "P." në Prizren, në atë mënyrë që i padituri e ka lëshuar truallin, ndërsa paditësi ka marrë përsipër investimin në shumë prej 300.000 DM (treqind mijë marka gjermane) apo në kundërvlerë të euros në shumën prej 150.000. Pas ndodhjes së aksidentit tragjik me 04.07.2001, ku në pishinë kishte humbur jetën një i mitur, paditësi dhe i padituri kishin vendosur që ta ndërprejnë kontratën mbi investimin e përbashkët ashtu që ishin marr vesh që i padituri si pronar i paluajtshmerisë në të cilën është

ndërtuar pishina, ta mbaj në tërësi pishinën ndërsa paditësit t'ia kthej vlerën e investuar në shume prej 150.000 euro.

I autorizuari me autorizim zëvendësues i paditësit B. K. nga Prizreni, edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa në fjalën përfundimtare me shkrim ka theksuar se këtë borxh të të paditurit e vërtetojnë provat e administruara, përkatësisht kontrata e datës 16.05.2002, duke shtuar se edhe nga ekspertiza e forenzikës vërtetohet se nënshkrimi në kontratë është i të paditurit. Nga deklarata e dëshmitarit A. Sh. (e dhënë në procesverbalin e datës 05.06.2008), gjithashtu është vërtetuar se këtu palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje për kryerjen e obligimeve si në kontratën për pagesat e obligimeve të datës 16.05.2002. Me tej ka cekur se paditësi me rastin e arritjes së marrëveshjes për pagimin e borxhit nga i padituri, nga vetë fakti se janë miq të paditurit, i'a ka falur shumen prej 30.000 euro, ashtu që tani paditësi ka kërkuar vetëm shumen prej 120.000 euro. Ai ka theksuar se padia ka bazë ligjore ngase bazohet në faktin se palët kanë hyre me vullnetin e tyre në marrëveshje kontraktuese, ku më vonë me pajtimin e tyre edhe e kanë shkëputur këtë marrëveshje për shkaqet e cekura dhe se obligimi i të paditurit për kthimin e borxhit në emër të investimeve, është ligjor sepse kjo ka qene edhe pjese e marrëveshjes së palëve, andaj në baze të këtyre fakteve dhe provave i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit E. Sh. si të bazuar, duke e obliguar të paditurin që të paguaj vlerën prej 120.000 euro, në emër të borxhit për kthimin e investimeve të investuara nga paditësi E. Sh. në ndërtimin e pishinës "M.". Sa i përket shpenzimeve procedurale, të njëjtat i ka kërkuar dhe atë për shpenzimet si në vijim: për padinë 121 euro, për taksën për padi 40 euro, për 8 seanca të shtyera të llogaritura nga 60 euro për një seancë apo 420 euro, për 4 seanca të mbajtura të llogaritura nga 121 euro apo 484 euro, respektivisht shumën e tërësishme të shpenzimeve në lartësi prej 1065 euro.

I padituri F. K. përmes përgjigjes me shkrim në padi ka deklaruar se në tërësi i konteston theksimet në padi duke parashtruar kundërshtime procedurale lidhur me padinë e parashtruar, për të shtuar se padia është e paqartë, respektivisht nuk i plotëson kushtet ligjore që gjykata të veproj sipas saj. Ai gjithashtu ka cekur se padia për të qenë e qartë duhet t'i plotësoj kushtet e parapara me nenin 99-253 të LPK-së, kurse padia e parashtruar nuk i plotëson kushtet e cekura. Ndër të tjera ka shtuar se padia është e paqarte ngase nuk dihet se a është fjala për kompensimin e borxhit apo shkëputje e marrëveshjes së investimit të përbashkët. Sipas tij, pohimet e paditësit të cekura në padi janë të pa vërteta ku ceket se i padituri merr përsipër investimin dhe sigurimin e vlerës në të holla prej 300.000 DM ose 150.000 euro, sepse paditësi me të paditurin kanë pasur një marrëveshje për ndërtimin e një pishine në truallin e të paditurit me qëllim që të punojnë, fitojnë dhe humbin së bashku. Në baze të kësaj marrëveshje, pjesëmarrja e paditësit në investim të përbashkët ka qenë në shumë prej 50.000 dollar, kurse pjesëmarrja e të paditurit ka qenë gjithashtu me të holla pa e cekur shumën dhe truallin të cilin është ndërtuar objekti ku me marrëveshje gojore janë marrë vesh që do të punojnë në bashkësi dhe të gjitha fitimet dhe humbjet do t'i ndanin bashkërisht. Sa i përket marrëveshjes të cilën paditësi e ka cekur në padinë e tij, i padituri ka theksuar se e kundërshton në tërësi sepse e njëjta është përpiluar pa prezencën e tij dhe nuk është nënshkruar nga i padituri. Gjithashtu i padituri ka pasur bisedime me paditësin, që paditësi të punoj në pishinë për 3 vite me qëllim që t'i nxjerr investimet e veta, por edhe kjo ka dështuar sepse qëllimi i paditësit ka qenë uzurpimi i tokës ku është ndërtuar objekti. I padituri pas ndarjes, paditësit ia ka kthyer në emër të kompensimit për ndarje shumën prej 33.966 euro, dhe se ndaj paditësit, nga marrëdhënia e investimit të përbashkët, atij nuk i ka kurrfarë borxhi andaj edhe duke u bazuar në pohimet dhe faktet e cekura, gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: kontrata origjinale mbi pagesën e obligimeve të datës 16.05.2002, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.230101, i datës 07.12.2004, raporti i ekspertizës të Agjencionit të Kosovës për Forenzik me nr. referues AKF/2013-1782/2013-1486, të datës 08.07.2013, si dhe është bërë leximi i dëshmisë së dëshmitarit A. Xh. Sh., të dhënë në procesverbalin e datës 05.06.2008.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse provave të tjera në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo prove veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Në bazë të kontratës mbi pagesën e obligimeve të datës 16.05.2002, gjykata ka vërtetuar faktin se E. Sh. dhe F. K., kanë nënshkruar një marrëveshje për pagesën e obligimeve, në bazë të së cilës del se palët janë marr vesh për pagesën e obligimeve të investuara nga E. Sh., në shumë të përgjithshme prej 150.000 euro apo 300.000 DM dhe atë në shumë prej 30.000 euro (60.000 DM) të paguhet deri më datën 31.06.2002, ndërsa shuma prej 120.000 euro apo 240.006 DM të paguhet në afat prej dy vitesh gjegjësisht deri me 31.06.2004. Në bazë të kësaj kontrate del se E. Sh., i mbesin të gjitha obligimet e pagesës së borgjeve të cilat i ka pasur në pishinë. Sidoqoftë, gjykata ka konstatuar faktin se kjo kontrate nuk është e vërtetuar para ndonjë organi kompetent, por është nënshkruar nga palët kontraktuese dhe përmban vetëm një faksimil të avokatit B. N. nga Prizreni, me gjerësisht sikurse në këtë kontrate.

Me leximin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.230101, të datës 07.12.2004, gjykata ka konstatuar faktin se F. K. dhe E. Sh. janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar me dënim kusht, për shkak se kanë kryer veprën penale veprat e rënda kundër sigurisë së përgjithshme nga neni 157 al. 4 lidhur me nenin 164 al. 5 të Ligjit Penal të Kosovës, me gjerësisht sikurse në këtë aktgjykim.

Me leximin në raportin e ekspertizës të Agjencionit të Kosovës për Forenzik me nr. referues AKF/2013-1782/2013-1486, të datës 08.07.2013, gjykata ka konstatuar faktin se pas ekspertimit të nënshkrimit të të paditurit F. K., vërtetohet fakti se kontrata e datës 16.05.2002, në fakt është e nënshkruar nga i padituri F. K., me gjerësisht si në këtë raport.

Dëshmitari A. (Xh.) Sh., përndryshe vëllau i paditësit E. Sh., në dëshminë e tij të dhënë para kësaj gjykate me datën 05.06.2008, ka deklaruar se paditësi E. Sh. punon dhe jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe se i njëjti asokohe ka qenë i interesuar që të investoj në Kosovë. Duke marrë parasysh faktin se i padituri e ka pasur paluajtshmërinë në emër të tij, palët janë marrë vesh që të ndërtojnë një pishinë, ashtu që e njëjta do të ndërtohej në paluajtshmërinë e të paditurit, ndërsa që investimet në të do t'i bënte këtu paditësi. Në lidhje me këtë çështje, të njëjtit nuk kishin përpiluar kurrfarë kontrate me shkrim, por se ishin marrë vesh vetëm gojarisht. Që të dy kishin punuar bashkërisht deri në vitin 2001, kur edhe kishte ndodhur një aksident në pishinë, me ç'rast edhe për shkak të disa mosmarrëveshjeve me të paditurin, paditësi ishte tërhequr, ndërsa që aty kishte vazhduar të punoj vetëm i padituri. Sipas dëshmitarit, i padituri i kishte ngelur borxh paditësit shumë prej 120.000

euro, të cilën shumë ai ende nuk e kishte paguar. Sa i përket kontratës mbi pagimin e obligimeve, ka theksuar se e njëjta është nënshkruar edhe nga dëshmitarët e tjerë si M. K. dhe A. K. që janë vëllezërit e të paditurit si dhe është nënshkruar edhe nga vetë i padituri.

Baza Ligjore :

Me nenin 17 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) - Ligji Nr.3/3/1978, është parapare se "**pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij**", ndërsa me nenin 262 të këtij ligji, është parapare se "**kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij**".

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në baze të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë çështje kontestimore, nuk është provuar se këtu i padituri F. K. nga Prizreni, ka për detyrim që paditësit E. Sh., në emër të kompensimit të borxhit, t'i paguaj shumën prej 120.000 (njëqind e njëzete mijë) euro. Në rastin konkret paditësi nuk i ka ofruar gjykatës asnjë prove bindëse në lidhje me pretendimet e tij se i padituri i ka borxh atij nga investimi i përbashkët në ndërtimin e pishinës "M." afër "P." në Prizren, shumën e pretenduar. Në të vërtetë, në këtë çështje kontestimore nuk del të jetë kontestues fakti se të dy palët e kanë nënshkruar "kontratën" përkatëse mbi pagesën e obligimeve, ngase ky fakt është provuar edhe përmes raportit - ekspertizës së Agjencionit të Kosovës për Forenzik me nr. referues AKF/2013-1782/2013-1486, të datës 08.07.2013, nga ku del se nënshkrimi në këtë kontratë është i të paditurit F. K. Megjithatë nga përmbajtja e kësaj kontrate dhe mënyrës se si e njëjta është përpiluar, gjykata nuk ka mundur të provojë të drejtën e pretenduar të paditësit. Paditësi gjithashtu me asnjë prove nuk ka argumentuar se çka konkretisht ka investuar ai, sa ka investuar, se çfarë materiali ka investuar, çfarë objekti ka ndërtuar dhe se cilat kanë qenë marrëdhëniet konkrete kontraktuale të tij si investitor në truallin e të paditurit. Në fakt gjykata nuk ka mundur konstatoj se çka është ndërtuar, sa është investuar dhe kush ka investuar shumën e cekur në objekt të padisë. Paditësi i ka ofruar gjykatës provën respektivisht "kontrata mbi pagesën e obligimeve", të cilës kontratë gjykata nuk mund t'ia falë besimin për arsye se kjo kontratë edhe pse është e nënshkruar nga palët kontraktuese, nuk del të jetë e vërtetuar zyrtarisht pranë ndonjë organi kompetent, e as që në bazë të saj mund të kuptohet se cilat janë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese. Për më tepër në këtë kontratë, për atë sa mund të kuptohet, ceket se paditësit E. Sh., i mbesin të gjitha obligimet e pagesës së borxheve të cilat i ka pasur në pishinë.

Në anën tjetër, gjykata nuk mundi t'ia falë besimin as dëshmisë së dëshmitarit A. Sh., i propozuar për dëgjim nga vetë paditësi, ngase dëshmia e tij bie ndesh me provat e propozuara nga vetë paditësi, përkatësisht me "kontratën mbi pagesën e obligimeve" të datës 16.05.2002, ngase ky dëshmitar në dëshminë e tij ka theksuar se palët ndërgjyqëse nuk kishin nënshkruar kurrfarë marrëveshjeje me shkrim në mes tyre, por se ishin marrëveshje vetëm gojarisht, ndërsa që nga paditësi si prove materiale në këtë çështje kontestimore është paraqitur për administrim edhe "kontrata" e lartpërmendur e datës 16.05.2002. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata nuk mundi t'ia falë besimin dëshmisë së këtij dëshmitari.

Vlen të ceket se me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e parapare se "palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla", andaj përgjatë

tërë zhvillimit të procedurës, gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.4 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.713/05, datë. 19.11.2013.

Procesmbajtësja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

UDHËZIM JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.